

VENDIM
Nr. 180, datë 11.4.1997

**PËR PROKURIM ME PROCEDURE TË PËRSHPEJTUAR PËR DISA ARTIKUJ QË
LIDHEN ME PLOTËSIMIN E NEVOJAVE TË GATISHMËRISË**

Me propozimin e Ministrisë së Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për plotësimin e nevojave që lidhen me gatishmërinë për artikujt ushqimorë, veshmbathjes, kazermimit, automekanikës dhe ndërlidhjes, Ministria e Brendshme dhe organet e repartet në varësi të saj të përdorin “Kërkesën për kuotim” në kushtet e mëposhtme:

- Kufiri për çdo blerje deri në 5 milionë lekë.
- Shoqërisë fituese t’i kërkohet si dokumentacion ligjor licenca e ushtrimit të veprimtarisë dhe dokumenti i regjistrimit në organet tatimore.

2. Ministri i Brendshëm autorizohet të përcaktojë të gjitha nevojat që lidhen me gatishmërinë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe është i zbatueshëm për periudhën 12.4.1997-15.5.1997.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino